



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 15 korrik 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Çeljen e procedurës për lëshimin e 1 (një) licence rajonale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier dhe 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv tematik informativ, në qarqet Tiranë dhe Durrës. **(Vendimi nr. 82, datë 15.07.2022)**
2. Refuzimin e aplikimit dhe mosdhënien e autorizimit, shoqërisë “ALB-CRTV” sh.p.k., për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio. **(Vendimi nr. 83, datë 15.07.2022)**
3. Kalimin e të drejtave të autorizimit të subjektit person fizik Endri Leka, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor E&G”, tek shoqëria “AEG.NET” sh.p.k., si dhe ndryshimin e emrit të subjektit audioviziv nga “Tv Kabllor E&G” në “AEG.NET”. **(Vendimi nr. 84, datë 15.07.2022)**
4. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Mikel Jaho, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Toshkëz”. **(Vendimi nr. 85, datë 15.07.2022)**
5. Dhënin e autorizimit, shoqërisë “BULEVARD PRESS” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online, mbështetur në rrjet IP (IPTV) “Bulevard Tv”. **(Vendimi nr. 86, datë 15.07.2022)**
6. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “My TV-Alb” sh.p.k., dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 04 datë 27.04.2022, gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, vendosur ndaj subjektit OSHMA “My TV Alb”. **(Vendimi nr. 87, datë 15.07.2022).**
7. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Dritan Memushaj dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 03 datë 05.04.2022, gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, vendosur ndaj subjektit OSHMA “TV me kabëll Tepelena Sat”. **(Vendimi nr. 88, datë 15.07.2022).**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 15 korrik 2022